

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E FERIZAJT - OPSTINA UROSEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: / Date / Dana:	15 / 07 / 2013	
Nr. Orgv / Org. jed:	Nr. Prot. / Br. Prot.	Nr. Faqeve. / Br. Strana.
01	196	03
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA		
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA		
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH		
Njësia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit:	01	Nr. Prot. / Broj Prot. / Prot. No.:
		05-4216
Nr. i faqeve / Br. stranica / No. bačes:	-03-	Data: / Datum: / Date:
		17.07.13
Prishtinë / a		

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva
Ministry of Health

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

Në mes

Ministrisë së Shëndetësisë

dhe

Komunës së Ferizajt

Për projektin

“Ndërtimi i objektit të ri të Spitalit Regional në Ferizaj”

Prishtinë Korrik, 2013

Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna e Ferizajt janë pajtuar për financimin e këtij projekti që ka për qëllim përmirësimin e kushteve në Spitalin Regjional në Komunën e Ferizajt. Si rezultat i kësaj Marrëveshje, Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna e Ferizajt janë pajtuar që të bashkëfinancojnë këtë projekt:

1. “Ndërtimi i objektit të ri të Spitalit Regjional në Ferizajt”

Neni 1

1.1 Ministria e Shëndetësisë do të financojë projektin në fjalë gjatë vitit **2013-2015** në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtar.

1.2 Komuna e Ferizajt do të bashkëfinancojë projektin në fjalë gjatë vitit **2013-2015** me 300,000.00 euro, duke përfshirë me këtë shumë edhe financimin e projektit ideor dhe zbatues.

1.3 Komuna e Ferizajt me vendim të Kuvendit Komunal për këtë qëllim ka ndarë një parcelë tokësore në një hapësirë prej 3 hektarësh e gjysmë.

1.4 Ministria e Shëndetësisë do të financojë projektin në fjalë gjatë vitit 2013-2015; me 200.000,00 euro në vitin 2013 dhe në vitet në vijim në pajtim me kornizën afatmesme të shpenzimeve 2014-2016.

Neni 2

Menaxhimi i Projektit

3.1 Këshilli Drejtues i Projektit

Për të siguruar mbarëvajtjen dhe transparencën e projektit si dhe kualitetin e punëve nënshkruesit e marrëveshjes janë dakorduar ta themelojnë Këshillin Drejtues të Projektit i cili ka për detyrë ta drejtojë zhvillimin e projektit në tërësi sipas dokumentacionit teknik dhe në kuadër të buxhetit të alokuar .

Pjesëmarrës në këtë Këshill do të jenë :

- Koordinatorët e projektit të caktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna e Ferizajt.
- Kontraktori i përzgjedhur për kryerjen e punimeve ndërtimore
- Përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komunës së Ferizajt për mbikëqyrjen profesionale të zbatimit të punëve

3.2 Detyrat e Këshillit Drejtues janë :

- 1 . Drejtimi i projektit në tërësi sipas dokumentacionit teknik dhe ofertës së përzgjedhur
2. Monitorimi i mbarëvajtjes së projektit, përfshirë këtu:
 - Dinamikën dhe kualitetin e kryerjes së punimeve ndërtimore
 - Kualitetin e shërbimeve të ndërmarrjes mbikëqyrëse të punimeve dhe
 - Kualitetin e shërbimeve të hartuesit të projektit
 - Respektimin e dokumenteve kontraktuese

3.3 Raportimi

Këshilli drejtues do të hartojë raportet nga përmbledhja e raporteve të pjesëmarrësve në projekt në bazë të aktiviteteve të tyre të përditshme. Raportet e përmbledhura në këtë mënyrë do t'i dërgohen të gjitha palëve pjesëmarrëse në Këshill si dhe veçmas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komunës së Ferizajt.

Neni 3

Procedura e Prokurimit

4.1 Ministria e Shëndetësisë do të udhëheq procedurat e prokurimit sipas Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës dhe të nënshkruaj kontratën me Kontraktoret e përzgjedhur në këtë bashkëfinancim

4.2 Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna do të merren vesh për mënyrën e kryerjes së pagesave ndaj kontraktuesit të punëve ndërtimore dhe kontraktuesit të mbikëqyrjes. Pagesa do të bëhet në pajtim me kushtet e kontratës, në bazë të vlerësimit dhe situatës së aprovuar të punimeve të kryera nga organi mbikëqyrës dhe Këshilli Drejtues i projektit.

4.3 Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna do të merren vesh për përzgjedhjen e Komisionit për pranim teknik të punëve në bazë të dokumentacionit teknik të hartuar pas zbatimit të kryerjes së punimeve.

Neni 4 Përfundimi i Marrëveshjes

Përfundimi i Kontratës ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komunës bazohet në procesin e vlerësimit përfundimtar tekniko-financiar të Komisionit për pranimin teknik e financiar të projekteve.

Neni 5 Praktikat joetike

Palët deklarohen se çfarëdo oferte, dhuratë, shpërblim ose ndonjë përfitim tjetër, i cili është kryer ose duhet të kryhet me njohuri të drejtpërdrejt apo të tërthortë të palëve, nga ndonjë person që ka lidhje me përmbushjen e kësaj Marrëveshje, ose nga çfarëdo kontrate tjetër e lidhur me të, do të konsiderohet akt jo i ligjshëm dhe korrupsion.

Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


Palët bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që kanë ndërmjet veti, përmes mirëbesimit ose bisedimeve të përbashkëta. Ndonjë konflikt, kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes duke përfshirë esencën e saj, validitetin apo përfundimi duhet të zgjidhet nga Gjykata kompetente.

Neni 7 Amandamentet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e dyanshëm të nënshkruesve të marrëveshjes.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do të fillojë të zbatohet nga dita e nënshkrimit të saj.


Ministria e Shëndetësisë
Prof. Dr. Ferid Agani, Ministër


Komuna Ferizaj
Agim Aliu, Kryetar